

REAGIMI I PROJEKTIT AQH NDAJ SHPËRTHIMIT TË COVID-19

Publikimet më poshtë janë materiale të krijuara dhe publikuara nga AQH, Ministrija e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Kosovë



ZËRI I PROJEKTIT AQH NË MEDIAT SOCIALE SI NJË BURIM I BESUESHËM PËR INFORMACIONE RRETH SHËNDETIT

Përmes krijimit të mesazheve të besueshme rreth shëndetit, faqet e mediave sociale të AQH'së po shërbejnë si një burim i besueshëm informacioni për publikun e gjerë. Informacioni i bazuar në udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë që shpërndahet përmes mediave sociale të AQH'së arrin deri tek 250,000 njerëz, si dhe po shpërndahet më tej, nga institucionet shëndetësore në Kosovë, OJQ-të, revistat shëndetësore në internet dhe profesionistët e shëndetit.

Përderisa vendi po lufton pandeminë COVID-19, njerëzit po përpiqen të gjejnë informacione të besueshme, prandaj Komunikimi i Përshtatshëm për Ndryshimin e Sjelljes (Appropriate Behavior Change Communication - BCC), duke synuar popullsinë e përgjithshme, grupet e cënueshme, si të moshuarit, pacientët me SJT, komunitetet pakicë dhe profesionistët e vijës së parë, është thelbësor. AQH po punon ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë për një përgjigje efektive dhe në kohë.

AQH po mbështet në vazhdimësi ekspertë dhe vendimmarrës nga institucionet partnere në fushën e komunikimit. Mesazhet, që janë të publikuara edhe në gjuhët e komuniteteve pakicë, synojnë të informojnë popullatën për masat e mbrojtjes, si dhe të shmangin informimin jo të drejtë për COVID-19.

SESIONE VIRTUALE TË TRAJNIMIT PËR 'MENAXHIM TË CILËSISË' ME KOMUNAT E PROJEKTIT

Përderisa po punohet në distancë dhe online, ne po vazhdojmë të mbështesim ofrimin e punësive për Menaxhim të Cilësisë në mënyrë virtuale.

AQH përmes ekspertëve të saj ndërkombëtarë dhe vendor po mban sesione trajnimi për Menaxhimin e Cilësisë për 12 komuna të projektit me qëllim që ti mbështes në përdorimin e mjeteve të Menaxhimit të Cilësisë për t'i përmirësuar shërbimet e ofruara në situata emergjente, përfshirë pandeminë COVID-19.

Shihni foton më lart nga bashkëbisedimi i kolegëve tanë, mentorëve vendor dhe ndërkombëtarë.

RRI N'SHPI - MBROJE JETËN!

Për të luftuar përhapjen e COVID-19, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes projektit të saj AQH mbështeti MSH dhe IKSHPK në zhvillimin e fushatës “Rri n'shpi, mbroje jetën”. Në vazhden e situatës aktuale, ne synuam të ju drejtohem komunitetit tonë dhe t'i inkurajojmë ata të qëndrojnë të sigurt, duke vlerësuar lart punën e atyre që janë në vijën e parë të frontit në luftën me koronavirusin.

Ju lutem klikoni [këtu](#) për mesazhet frymëzuese dhe domethënëse mbi atë se çfarë duhet të bëjë popullata për të ndihmuar në ndalimin e përhapjes.

**AQH Project**
April 26 at 11:39 AM · 🌐

Rri n'shpi-Mbroje jetën!
Rri n'shpi-Mbroje jetën!... See More



ARBEN VITIA
MINISTËR I SHËNDETËSISË

 Like  Comment  Share

    1.4K · 77 Comments

MBËSHTETJA E AQH'SË PËR KOMUNITETIN ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN

Përderisa koronavirusi po përhapet në të gjithë globin, duket se po ekspozon pabarazitë ekzistuese dhe po zgjeron ndarjet sociale dhe ekonomike. Për të shtuar rezistencën e komuniteteve të cënueshme, siç janë komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, Projekti AQH do të jetë në kontakt me ta ditëve në vijim për të ju dërguar mesazhe informuese për parandalimin e infektimit dhe pako me artikuj ushqimorë, mbrojtës dhe higjienik . Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe OJQ-të partnere, rreth 3,000 familje të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian pritet të përfitojnë nga kjo mbështetje.

AQH I FALËNDERON HERONJTË!

Faleminderit të gjithë punonjësve shëndetësor që punojnë pa u lodhur dhe pa menduar për veten në vijën e parë të frontit në luftën me pandeminë COVID-19. Ne e vlerësojmë shumë që ju po rrezikoni shëndetin tuaj për t'u kujdesur për komunitetin tonë.

'Thanks health heroes'
'Faleminderit heronj të shëndetit'
'Hvala herojima zdravstva'
'Oven saste heroia e saslaripeske'

